KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE TIRANË

# RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR
## (Raport i Fakteve të Gjetura)

---

## Mbi Auditimin Ligjor të Fondeve të Përftuara dhe të Shpenzuara Gjatë vitit kalendarik 2018 nga "Partia Sfida"

Silvana Gjikdhima
Eksperte Kontabel e Regjistruar
04/06/2019

**RAPORT**

**I**

**FAKTEVE TE GJETURA**

**Për : KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**TIRANË**

Ne kemi kryer procedurat e rena dakort me ju ne kontraten e lidhur ndermjet paleve ne date 19.04.2019 qe do te pershkruhen me poshte, lidhur me fondet e perftuara dhe te shpenzuara gjate vitit 2018 nga "Partia Sfida"

Angazhimi yne u krye ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit dhe ne veçanti me SNA 4400 te zbatueshem ne angazhimet per procedurat e rena dakort.

Procedurat u kryen vetem per t'ju ndihmuar juve qe te percaktoni fondet e perftuara dhe te shpenzuara gjate vitit 2018 nga "Partia Sfida " te cilat jane permbledhur me poshte :

1.Ne morem nga KQZ Vendimin Nr.152 te datës 11.04.2019 per kryerjen e auditimit ligjor te fondeve te perftuara dhe te shpenzuara ne vitin 2018 nga "Partia Sfida " .

2.Ne morem nga KQZ listën e partive politike te regjistruara pranë Gjykatës së Rethit Gjyqësor Tiranë në te cilen ishte rregjistruar "Partia Sfida "

3.Ne derguam me poste Rekomande me Lajmërim Marrje: RR 843245515 AA dt 03/05/2019 " Kerkese per dergim te dhenash " Partise Sfida „ ne adresen Rr: "Sami Frasheri",Pall.Delta (prane ish Ekspozites Shqiperia Sot),Shk 2, Tirane .

Ne raportojme gjetjet tona si me poshte :

Ne lidhje me piken 3 ne konstatuam se : Kontaktuam me Z.Sokol Golemi e Znj.Alba Aliaj(e cila ka firmosur per marrjen ne dorezim te kerkeses per dergim te dhenash me lajmerim marrje : RR 843245515 AA),te cilet na vune ne dispozicion vetem nje pjese te dokumentacionit ku perfshihej nje pjese e statement te llogarive bankare si dhe bilanci i vitit 2018 dorezuar elektronikisht ne faqen e tatimeve.
Kur i kerkuam pjesen plotesuese te dokumentacionit dhe firmosjen e kontrates,Znj.Alba me tha se partia nuk ekziston dhe per rrjedhoje nuk ka kush te na firmose kontraten e te na jape informacionin shtese qe na duhej per te permbyllur auditimin e partise "Sfida"per vitin 2018.
Pasi komunikuam me e-mail (per te cilin eshte vene ne dijeni dhe KQZ) me Znj.Alba,ku e informonim se ne kushtet e permendura me lart,nuk mund te kryenim auditimin per mungese bashkepunimi nga ana e partise,ajo na tha se nuk ishte pjese e partise "Sfida",dhe se kryetari i kesaj partie Z.Hektor Ruçi ndodhej jashte shtetit dhe do te na kontaktonte sapo te kthehej.

Duke qene se kryetari nuk na kontaktoi asnjehere, ne kushtet e mungeses se bashkepunimit nga ana e partise, nuk mund te shprehim asnje opinion per fondet e perftuara dhe te shpenzuara gjate vitit 2018 nga "Partia Sfida" .

Bashkengjitur nje kopje e dokumentit te postes,si dhe nje pjese e komunikimit me e-mail.

**Eksperte Kontabel e Regjistruar**

**Silvana Gjikdhima**

SILVANA GJIKDHIMA
E.K. LICENS NR 182
NIPT K 32202008 F

1. PËR TU PLOTËSUAR NGA ZYRA PRANUESE E LAJMERIMIT

Objekti........................................Nr..............datë....................Lek......................

Është pranuar në zyrën........................................................................në drejtim të zotit

Z. Hektor Ruçi

Partia Shida

Rr. Sami Frashëri, Pall. Delta (pranë ish Ekspoz. Shqipëria Sot)

Shk. 2, Tiranë

2. PËR TU PLOTËSUAR NGA ZYRA MARRËSE E OBJEKTIT

Objekti i sipërtreguar është........................................................................ Dorëzuar në datën..........

Paguar

Emri mbiemri i marrësit të objektit Alda Alia

Emri mbiemri i shpërndarësit

SHËNIME TË VEÇANTA

Vula datare e Zyrës Dorëzuese të objektit

**Subject:** Statementet e bankes dhe fatura
**From:** Sokol Golemi (sgolemi@yahoo.com)
**To:** silvagjikdhima@yahoo.com;
**Date:** Saturday, May 18, 2019 10:03 PM

Pershendetje Silva!

Po te nis te skanuara stetementet e bankes dhe faturen.

Gjithe te mirat

Sokoli

---

## Attachments

- Banka1.pdf (1.32MB)
- Banka2.pdf (670.50KB)
- Banka3.pdf (1.70MB)
- Banka4.pdf (1.14MB)
- fatura.pdf (262.29KB)

**Subject:** Mbi auditimin e partise "Sfida" per vitin 2018

**From:** YAH00&INC (silvagjikdhima@yahoo.com)

**To:** sgolemi@yahoo.com; albaaliaj8@gmail.com;

**Cc:** mirela.gega@cec.gov.al;

**Date:** Sunday, May 26, 2019 5:16 PM

Pershendetje,

Ne pergjigje te bisedes telefonike me Znj.Alba, e cila me tha se partia "Sfida" nuk ekziston e per rrjedhoje nuk ka kush te me likuidoje e te me jap dokumentat plotesuese qe kerkova (nderkohe qe nje pjese e dokumentave me ishin vene ne dispozicion nga Z.Sokol Golemi) ju sqaroj:

1-Qe partia te mos ekzistoje duhet te çregjistrohet me vendim gjykate (ne KQZ Partia figuronte e regjistruar)
2-Per vitin 2018 Partia kishte mbyllur e dorezuar ne tatime Bilancin qe mu vu ne dispozicion nga ana juaj.
3-Gjithashtu mu vune ne dispozicion dhe statement bankare per vitin 2018,ku dukej qarte qe partia kishte disa te ardhura dhe shpenzime per vitin 2018.

Ne keto kushte jam e detyruar te ve ne dijeni dhe KQZ-ne (ne CC e e-mailit),per mungese bashkepunimi midis partise suaj dhe auditueses ligjore.
Ju kujtoj se per mungese bashkepunimi me audituesen ligjore, **Ligji per Partite Politike Nr.8580, datë 17.2.2000 Ndryshuar me ligjin nr. 10374, datë 10.2.2011, Neni 23/4 Paragrafi 2 thote:**

**Shkelja e detyrimit për bashkëpunim me ekspertin kontabël të licencuar, të caktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nga ana e partisë politike, dënohet me gjobë nga 1 000 000 deri në 2 000 000 lekë.**

Nese nuk me lidhni kontraten dhe nuk me vini ne dispozicion dokumentat plotesuese te kerkuara, do te njoftoj KQZ-ne me shkrese zyrtare.

Jam ne pritje te nje pergjigjeje nga ana juaj,per te ditur si te veproj ne vazhdim.

Ju faleminderit,
Silvana Gjikdhima

**Subject:** Re: Mbi auditimin e partise "Sfida" per vitin 2018
**From:** YAH00&INC (silvagjikdhima@yahoo.com)
**To:** albaaliaj8@gmail.com;
**Cc:** sgolemi@yahoo.com; mirela.gega@cec.gov.al;
**Date:** Wednesday, May 29, 2019 4:11 PM

Pershendetje Znj.Alba,

Pavaresisht se ju nuk jeni dhe nuk keni qene asnjehere pjese e partise "Sfida",une kam komunikuar me kryetarin e partise vetem nepermjet jush,dhe asnjehere personalisht.
Siç keni shkruar me poshte me keni dhene nje pjese te informacionit per partine per te me ardhur ne ndihme,dhe me pas me thate qe partia nuk ekziston dhe nuk ka kush te me likuidoje.
Gjithashtu ne mesazhin e fundit telefonik qe me keni derguar, me thate se folet me kryetarin dhe se ai do te me kontaktonte personalisht per te me sqaruar si te veproja me tej, ne lidhje me auditimin e partise.

Meqenese kryetari nuk me kontaktoi,dhe une me kryetarin kam komunikuar vetem nepermjet jush, po ju njoftoj se une do raportoj prane KQZ-se, me shkrese zyrtare ku do te perfshij dhe informacionin e derguar me e-mail ne date 26.05.2019.

Ju faleminderit,
Silvana Gjikdhima

---

**From:** Alba Aliaj <albaaliaj8@gmail.com>
**To:** YAH00&INC <silvagjikdhima@yahoo.com>
**Cc:** Sokol Golemi <sgolemi@yahoo.com>; Mirela Gega <mirela.gega@cec.gov.al>
**Sent:** Wednesday, May 29, 2019 11:09 AM
**Subject:** Re: Mbi auditimin e partise "Sfida" per vitin 2018

Pershendetje znj.Gjikdhima,

Ju bej me dije se une nuk kam qene ndonjehere dhe nuk jam pjese e partise "Sfida ".
Une jam punonjese e nje tjeter shoqerie, ne ambientet e te ciles gjenden arkiva e pjesshme e shkresave te "Sfides" dhe per kete arsye disa informacione ju jane dhene nga ana ime (per t'ju ardhur ju ne ndihme).

Faleminderit per mirkuptimin.
Pune te mbare!
Alba Aliaj